



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

### **Nr. 13**

Datë: 12. 04. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Čemailj Kurtiši, Rifat Krasniq, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit Nr. 12/2022:**
- 3. Aktivitetet e SKQZ:**
- 4. Aktivitetet e ZRPPC:**
- 5. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

#### ***Këshilli për Çështje Ligjore:***

*Shqyrtimi dhe Miratimi i Kërkesave, për Zëvendësimin e Anëtarëve të Kuvendit Komunal, në Komunitat : Rahovec, Gjilan, Hani i Elezit, Mitrovicë e Jugut, Obiliq*

***Këshilli për Operacione Zgjedhore:***

*Shqyrtimi dhe Miratimi i Projektit dhe Agjendës për Punëtorinë Ndryshimi dhe Plotësimi i Rregullave Zgjedhore të KQZ-së,*

*Shqyrtimi dhe Miratimi i Raportit të Krahasimit nga Rinumërimet e Zgjedhjeve Lokale 2021*

***Këshilli për Buxhet dhe Financa:***

*Shqyrtimi dhe Miratimi i Planifikimit të Buxhetit për Punëtorinë për Ndryshim dhe Plotësimin e Rregullave Zgjedhore;*

*Shqyrtimi dhe Miratimi i Raportit të Komisionit për Vlerësimin e Pasurisë jo Financiare të KQZ-se;*

***7. Të ndryshme.***

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

Në hyrje të mbledhjes, kryetari Kreshnik Radoniqi, paraqiti agjendën e mbledhjes dhe, e informoi KQZ-në për marrjen e një ftese nga IFES për pjesëmarrje në një trajnim në Ceki. Po ashtu, një kërkesë është dorëzuar nga z. Buzhala. Ai, propozoi që këto dy pika të jenë pjesë e agjendës së mbledhjes. Arianit Elshani, anëtarë i KQZ, propozoi që nga te aktivitetet e DOZ-it, të largohet nga shqyrtimi dhe të lihet për mbledhjen e ardhshme, pika: “Shqyrtimi dhe Miratimi i Raportit të Krahasimit nga Rinumërimet e Zgjedhjeve Lokale 2021”.

Në vazhdim, u miratua rendi i ditës. Me vërejtjet e z. Sami Kurteshi në mënyrë që ato të inkorporohen më tej në tekst, u miratua procesverbali nr. 12/2022.

**2. Aktivitetet e SKQZ:**

**Xhemajl Pecani**, zëvendëskryeshef, e lexoi raportin e aktiviteteve të SKQZ-së mes dy mbledhjeve, i cili raport paraprakisht, iu dërgohet anëtarëve të KQZ-së dhe, i njoftoi anëtarët e KQZ-së mbi koncept-dokumentin e ligjit për zgjedhjet lokale.

### **3. Aktivitetet e ZRPPC:**

*(P.s. Mbetet për mbledhjen e radhës...)*

### **4. Raport i Këshillave të KQZ-së**

#### **1.Këshilli për Çështje Ligjore:**

Shqyrtimi dhe Miratimi i Kërkesave, për Zëvendësimin e Anëtarëve të Kuvendit Komunal, në Komunat: Rahovec, Gjilan, Hani i Elezit, Mitrovicë e Jugut, Obiliq

**Sami Hamiti**, paraqiti një informatë mbi trajtimin e pesë (5 ) rregullave zgjedhore në dy mbledhjet e mbajtura të këshillit. Ai tha se, shqyrtimet e rregullave do të vazhdojnë në punëtorinë që do të mbahet në Strugë të Maqedonisë. Po ashtu, tha z. Hamiti, janë shqyrtuar edhe miratuar në këshillë edhe zëvendësimet e asamblistëve për kuvendet komunale.

**Kreshnik Radoniqi:** Në komunën e Rahovecit, asamblisti Artan Asllani zëvendësohet nga Alban Bajraltari nga subjekti politik AAK. Kush është për...?

Miratohet, me 10 vota.

Në komunën e Hanit të Elezit, asamblisti Qamush Brava, zëvendësohet nga Hatmije Kalisi nga subjekti politik AAK. Kush është për...?

Miratohet me 10 vota.

Në komunën e Gjilanit, ansambleisti Kadir Huseini, zëvendësohet nga Emrah Ismajli nga subjekti politik KDTP. Kush është për...?

Miratohet, me 10 vota.

Në komunën e Obiliqit, ansambleistja Katarina Agjanqiq, zvëndësohet nga Biljana Spasiq, nga subjekti politik “Serbska Lista”. Kush është për...?

Miratohet, me 10 vota.

Në komunën e Mitrovicës së Jugut, ansambleisti Armend Agolli zvëndësohet nga Oltion Ahmeti nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet, me 10 vota.

## **2.Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

Shqyrtimi dhe Miratimi i Projektit dhe Agjendës për Punëtorinë Ndryshimi dhe Plotësimi i Rregullave Zgjedhore të KQZ-së:

**Arianit Elshani**, tha se KOZ ka shqyrtuar draft projektin dhe agjendën e punëtorisë që do të mbahet. Në draft, janë planifikimet organizative. Na parim, ky është një draft, por që mund të diskutohet sidomos nga këshilli për çështje ligjore sepse, ata direkt janë marrë me trajtimin e rregullave...

**Sami Hamiti**, tha se në këtë format do të trajtohet këtu secila rregull, dhe atje në punëtori ! Në parim, agjenda është mirë...

**Sami Kurteshi**, po ashtu tha se janë trajtuar në këshill rregulla, por mendoj se duhet edhe më shumë kohë që rregullat të trajtohen dhe ndryshohen ashtu që s’do të kemi më nevojë të merremi me to. Z. Kurteshi, diskutoi edhe rreth agjendës së mbajtjes së punëtorisë, vendit, pjesëmarrësve etj. Në fund, ai tha se nuk “është në gjendje ta votojë këtë agjendë e cila, ende nuk është e qartë...”!

Xhemail Pecani, informoi se punëtorja sponsorizohet nga OSBE, dhe me gjasë do të mbahet në Strugë (Maqedoni).

Në këtë pikë, kryesisht lidhur me organizimin e punëtorisë, asketeve teknike, numrit të pjesëmarrësve etj., diskutoi edhe: Alim Rama, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj dhe Čemailj Kurtiši,

Në fund, kryetari Kreshnik Radoniqi, e hodhi në votim projektin e agjendës për punëtorinë: “Ndryshimi dhe Plotësimi i Rregullave Zgjedhore të KQZ-së”.

Me pesë ( 5 ) vota për, dhe tri ( 3 ) vota abstenim projekti nuk u miratua.

Në kontekst, **Ilir Gashi**, tha se, meqë nuk kaloi ky projekt, atëherë hiqet pika e diskutimit për buxhetin...nuk ka pse të diskutohet...!

Ndërsa kryetari Kreshnik Radoniqi, tha se siç mund të jeni në dijeni, është formuar këshilli i Presidencës për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut. Në samitin e mbajtur në dhjetorë të vitit të kaluar, i organizuar nga presidenti Bajden, Kosova ka marrë disa obligime mbi demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Aty, në këto “obligime” hyn edhe KQZ-ja. Janë dy pika: njëra që ka të bëjë me ZRPP-në, dhe tjetra, me partitë politike...

Deri kah fundi i këtij viti, ndoshta përmes KQZ-së, partitë politike zotohen, ato do ta nënshkruajnë një marrëveshje (deklaratë). Pika tjetër, ka të bëjë me i identifikua financat që, potencialisht mund të vijnë financa që financojnë partitë nga jashtë...

Janë krijuar katër këshilla, që edhe ne mund të kemi pjesëmarrje por, kjo le të mbetet të shqyrtohet pasi të marrim informatat e nevojshme...

**Të ndryshme !**

---

**Për KQZ**

**Kryetari, z. Kreshnik Radoniqi**

-----